

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime prioritare

Nr.	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
8	Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e administratës zgjedhore, duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të sistemit të emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të administratës zgjedhore të nivelit të ulët. Duhet të merren masa për të ndaluar zëvendësimet arbitrare të anëtarëve të administratës zgjedhore.	Progres i Pamjaftueshëm	Përpyjekja e parë për të ndryshuar parimin dhe rregullat sipas të cilit formohen komisionet zgjedhore janë ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor, në 2020, për strukturën dhe mënyrën e zgjedhjes së antarëve të KQZ. Megjithë këtë, është e rëndësishme të theksohet se edhe këto ndryshime, të cilat krijojnë kushte për të depolitizuar këtë institucion, nuk u zbatuan, sepse partitë politike ranë dakort që formimi i i KQZ të bëhej duke zbatuar, për këtë qëllim dispozitat kalimtare të përfshira në Kodin zgjedhor. Shfuqizimi i nenit 183, me ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor, Korrik, 2024 e përforcuan akoma edhe më shumë qëndrimin refraktar të partive politike ndaj këtij rekomandimi të OSBE/ODIHR. Partitë politike, PS e PD nuk kanë shprehur asnjë angazhim ose vullnet për të ndryshuar parimin dhe rregullat sipas të cilave ndërtohen aktualisht komisionet e nivelit të dytë e të tretë dhe grupet e numërimit të votave. Të gjithë antarët e kësaj administrate caktohen mbi bazën e propozimeve të partive politike. Për ndërtimin e tyre përdoret parimi i përfaqësimit dhe balancimit politik. Pavaresisht nga kërkesa e përsëritur e vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR për rishikimin e të drejtës së partive politike për të shkarkuar, pa dhënë asnjë arsye, kur të duan, antarë të komisioneve zgjedhore, neni 32. pika 2(d), kjo dispozitë vazhdon të mbetet në fuqi. Partitë politike janë të vendosura dhe këmbëngulëse për të mos e ndryshuar këtë dispozitë.